



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 08
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 17 Janar 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Faton Topalli, Haxhi Avdyli, Flora Brovina, Bekim Haxhiu dhe Fikrim Damka.

Munguan: Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Naser Rugova dhe Time Kadrijaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Valmir Xhemajli OJQ LENS, Durim Hoxha EYE, Drenusha Miftari EYE, Artan Murati KDI, Shefki Kastrati NDI dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës: 01.12.2017 dhe 11.12.2017;
3. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit për vitin 2018;
4. Shqyrtimi i projektligjit për ndërmarrjet sociale;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës: 01.12.2017 dhe 11.12.2017;

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratoi, pa vërejtje, procesverbalet e mbledhjes së komisionit, të mbajtur më datë: 01.12.2017 dhe 11.12.2017.

3. Shqyrtimi i draft- planit të punës së Komisionit për vitin 2018;

Besa Baftiu: Kemi një draft të përgatitur i cili është bërë duke u bazuar në programin legjislativ. Janë të përfshira edhe vizitat në institucione të caktuara. Janë paraparë edhe raportimet e ministrave. Po ashtu parashihen që ti bëjmë edhe dy monitorime të ligjeve. Një ligj nga sektori i shëndetësisë dhe një nga i punës dhe i mirëqenies sociale. A keni ndonjë propozim apo ndonjë çështje tjetër të plotësohet?

Bekim Haxhiu: Sa i përket planit tek objektivat unë propozoj që të plotësohet mbikëqyrja e ministrive dhe institucioneve që kemi në fushëveprim si komision. Ndërsa sa i përket raportimit të ministrave në draft plan ishte raportimi i parë i ministrave. Unë konsideroj se duhet të planifikojmë edhe më herët që ti ftojme ministrat që të raportojnë për punën e tyre para komisionit dhe të koordinohemi edhe për agjendën legjislative me ministrat. Në këtë rast implementimi i ligjit për sigurimet shëndetësore nuk mund të behët pa ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të shëndetësisë dhe ligjit për sigurimet shëndetësorë. Në këtë rast ne duhet të kërkojmë nga ministri i shëndetësisë që këto dy ligje ti sjell me herët që të behët plotësimi i tyre.

Haxhi Avdyli: agjenda legjislative që është prezantuar nuk është shpresëdhënëse për reformën në shëndetësi. Ka mangësi të mëdha nuk është një qasje serioze që kemi pritur si nga pacientet, profesionistët shëndetësorë nga qytetaret në përgjithësi një reformë në shëndetësi. Sektori në shëndetësi është duke vuajtur nga shumë pa qartësi, mungesa në financim dhe nuk kemi një plan të qartë legjislativ për vitin 2018. Ne si komision duhet të jemi me këmbëngulës dhe të kërkojmë një përshpejtim të reformave në shëndetësi dhe të procedohen sa më shpejtë ligjet të cilat kanë nevojë të ndryshohen dhe plotësohen që u përmenden. Reformat në shëndetësi duhet filluar nga ndryshimi i ligjit për shëndetësi nga ky ligj derivojnë edhe ndryshimet tjera ligjore dhe nënligjore në këtë rast edhe Statuti i SHSKUK-së. Në këtë rast nëse dëshirojmë reformë në sektorin e shëndetësisë duhet ti qasemi ndryshimeve të dy ligjeve ligjit për shëndetësi dhe ligjit për sigurimet shëndetësore.

Flora Brovina: pajtohem plotësisht me diskutuesit lidhur me ndryshimet ligjore që duhet të ndodhin në sektorin e shëndetësisë. Po ashtu edhe në sektorin e punës dhe mirëqenies sociale ka nevojë për ndryshime ligjore në këtë rast është i domosdoshëm sa më parë të procedohet me ndryshimin e ligjit të punës që të ju ofrohet një mbrojtje më e mirë punëtorëve. Gjatë raportimit të ministrit të MPMS duhet të njoftohemi me hollësisht për trajtimin e kategorive të dala nga lufta veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe familjeve të dëshmorëve.

Enver Hoti: edhe unë pajtohem plotësisht me diskutuesit lidhur me ndryshimet ligjore që duhet të ndodhin në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Sa i përket raportimit të ministrave duhet të ndahet në dy pjesë. Raportimi për programet dhe realizimin e projekteve kapitale të raportojnë në muajin shkurt po ashtu kemi 100 ditshin të cilin qeveria e ka kaluar dhe ti ftojme të raportojmë për këtë periudhë. Sfidat dhe planin e punës që e kanë prezantuar takimin e parë të shohim se sa kane punuar dhe a i kanë adresuar problematikat që i kanë identifikuar në fillim të mandatit.

Besa Baftiu: ne e theksuam se është vetëm një draft plan dhe mund të plotësojmë bashkërisht. Raportimi i ministrave mund të ndodhe në çdo moment që e vlerëson komisioni se për një çështje të caktuar duhet të ftojme që të raportojnë para komisionit. Nëse kërkoni ne mund ti ftojme edhe javën e ardhshme që të vijnë të raportojnë. Unë pajtoj me ju se ligjet të cilat janë shumë të rëndësishme që duhet të ndryshohen sa i përket reformave në shëndetësi janë në fund të programit legjislativ apo sesionin vjeshtor. Po plani është përgatitur në bazë të programit legjislativ. Sa i përket ligjit për shëndetësi ne si komision e kemi monitoruar këtë ligj për një kohë relativisht të gjatë. Kemi vizituar institucione shëndetësorë dhe kemi identifikuar po thuajse të metat dhe mangësitë, vështirësitë më të cilat ballafaqohen profesionistët shëndetësor dhe nevojat që ka ky sektorë dhe të cilat duhet adresuar gjatë ndryshimit të këtij ligji. Pajtoj me ju se ky ligj duhet të vijë me herët në ndryshim dhe plotësim.

Flora Brovina: ne si komision pas aktualizimit të çështjes së pagës minimale duhet të japim kontributin tonë të ftojmë ministrin dhe të diskutojmë për këtë çështje.

Bekim Haxhiu: përveç raportimit të ministrave para komisionit në duhet të angazhohemi edhe në mbikëqyrjen dhe raportimin para komisionit edhe institucioneve tjera si inspektoratin e punës, agjencinë për produkte medicinale e në veçanti kur kemi në diskutim pagën minimale ti takojmë Këshillin Ekonomiko Social.

Faton Topalli: në bazë të diskutimeve të gjithë ndajmë mendimin se ligji i punës duhet të ndryshohet. Është një ligj i cili më shumë mbështet punëdhënësit se sa punëmarrësit. Pra ne si komision të kërkojmë nga MPMS që të na njoftoj se ku janë me përgatitjet për ndryshimin e ligji të punës.

Kryetarja: ne kemi pasur në raportim ministrin e MPMS dhe ka premtuar se dhe ligji i punës do të jetë njeri nga ligjet që do të plotësohet mirëpo në programin legjislativ nuk është paraparë. Ne do të ftojme ministrin dhe do të kërkojmë bashkëpunim lidhur me këtë çështje.

Komisioni, pas diskutimeve dhe propozimeve për plotësimin e planit të punës, mbeti që plani i punës të diskutohet dhe miratohet në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i projektligjit për ndërmarrjet sociale;

Kryetarja: projektligji për ndërmarrjet sociale ka kaluar në lexim të parë andaj ne si komision duhet të fillojmë me amendamentimin tije. Ne si komision po e themelojmë grupin punues i cili do të shqyrtoj dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

Pas diskutimeve që u zhvilluan lidhur me propozimin për grup punues, komisioni nxori këtë:

V E N D I M

1. Formohet Grupi punues për shqyrtimin e projektligjit Nr. 06/L-022, për Ndërmarrjet Sociale.
2. Grupi punues ka këtë përbërje:
 - 2.1. Faton Topalli – Kryesues
 - 2.2. Flora Brovina – anëtare
 - 2.3. Enver Hoti - anëtar

- 2.4. Besa Baftiu – anëtare
- 2.5. Haxhi Avdyli - anëtar
- 2.6. Time Kadrijaj - anëtare

3. Grupi punues në bashkëpunim më stafin mbështetës të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

5. Të ndryshme;

Kryetarja – ne si komision e kemi obligim të mbikëqyrim zbatimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeveris së Kosovës dhe UnicreditBank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Në këtë rast edhe këtu duhet të formojmë një grup punues i cili do të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj marrëveshje.

Komisioni, pas diskutimeve që u zhvilluan lidhur me propozimin për grup punues, komisioni nxori këtë:

V E N D I M

1. Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeveris së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

2. Grupi punues ka këtë përbërje:

- 2.1. Fikrim Damka – Kryesues
- 2.2. Besa Baftiu – anëtare
- 2.3. Bekim Haxhiu - anëtar
- 2.4. Naser Rugova - anëtar
- 2.5. Time Kadrijaj - anëtare

Bekim Haxhiu: propozoj që ne si komision të realizojmë një takim me Ministrin e MSH-së se bashku me drejtoret e dikastereve në ministri. Për të diskutuar problemet të cilat janë në sektorin e shëndetësisë.

Kryetarja – propozojmë që të realizojmë një takim me Ministrin e MSH-së se bashku me drejtoret.

Komisioni vendosi që të martën, më datë 23.01.2018, të realizojë vizitën në Ministrinë e Shëndetësisë-MSH, të takojë Ministrin e MSH se bashku me drejtoret e MSH-së. Të diskutojnë për planin e punës dhe programin legjislativ për vitin 2018.

Ju faleminderit për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU